

Mars, 2016

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC) NË
KOSOVË, 01/2016**

PROJEKTI: MBËSHTETJE MEKANIZMAVE TË PJESËMARRJES PËR MONITORIMIN DHE
NDIKIMIN NË PROCEDURAT E VENDIMMARRJES

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri në Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e
mëtejme, OSBE) fton të gjitha OSHC-të e regjistruara për të shprehur interesim dhe për
të aplikuar për tri aktivitete të veçanta të mëposhtme në vitin 2016:

- A. Certifikimi profesional i OSHC-ve për monitorim dhe mbikëqyrje të
institucioneve lokale në Kosovë.**
- B. Trajnim profesional për OSHC të vogla për monitorimin dhe mbikëqyrjen
e institucioneve të caktuara të nivelit lokal në Kosovë**
- C. Zbatimi i projekteve të vogla në mbështetje të grupeve të grave që punojnë
për ngritjen e vetëdijes për dhunën në baza gjinore, me fokus në dhunën
në familje**

Është paraparë që OSHC-të mund të aplikojnë për 2 aktivitete të ndryshme në
maksimum. Projekti nuk parasheh financim të drejtpërdrejtë të OSHC-ve dhe as
mbulimin e shpenzimeve të personelit. Të gjitha mallrat dhe shërbimet do të blihen dhe
menaxhohen drejtpërdrejtë nga OSBE-ja. Termat e referencës dhe hollësitë për secilin
aktivitet më vete janë në dispozicion në gjuhën angleze në faqen e internetit të OSBE-së
(<http://www.osce.org/kosovo>) tek "Events".

Aplikimet për secilin aktivitet të veçantë duhet të dorëzohen në gjuhën angleze më së
largu deri më **04/04/2016** në adresën e e-mailit fitim.xharra@osce.org

ose

në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Për: Seksionin për Pjesëmarrje Publike
Misioni i OSBE-së në Kosovë
Prishtinë/Priština
Abdyl Frashëri, nr. 37
AKTASH
10000 Prishtinë/Priština, Kosovë

Për informata të mëtejme, ju lutemi të kontaktoni z. Fitim Xharra, Departamenti i
Demokratizimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në fitim.xharra@osce.org ose
038/240100, lokal 1154.